



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 19/4 Prot

Tiranë, më 27.01.2020

PROCESVERBAL

Sot, më datën 27.01.2020, ditë e hënë, ora 12:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, u mbajt mbledhja plenare e radhës e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, thirrur nga Kryetari, bazuar në nenet 164 deri në 167 të Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar.

Këshilli mbledhet në prani të anëtarëve si më poshtë:

1. Gent Ibrahim
2. Alfred Balla
3. Nurihan Seiti
4. Tartar Bazaj
5. Besnik Cani
6. Arben Dollapaj
7. Bujar Sheshi
8. Kosta Beluri
9. Vate Staka
10. Sander Beci
11. Esmeralda Keshi

Gjithashtu, janë të ftuar të jenë të pranishëm përfaqësues nga projektet OPDAT dhe EURALIUS, Ministria e Drejtësisë si dhe vezhgues nga organizata të tjera.

Nga administrata e KLP janë të pranishëm:

1. Drejtori i Kabinetit

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë z.Gent Ibrahim, i cili në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së



Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, pasi konstaton vlefshmërinë e mbledhjes, bën hapjen e saj dhe kalon në prezantimin e rendit të ditës:

Rendi i Ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme datë 20/01/2020 i cili u është shpërndarë anëtarëve nga Kryetari.
2. Miratimi i projektaktit “Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”.
3. Miratimi i projektaktit “Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.
4. Miratimi i projektaktit “Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.
5. Miratimi i projektaktit “Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
6. Miratimi i projektaktit “Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
7. Miratimi i projektaktit “Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet.
8. Miratimi i projektaktit “Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.
9. Miratimi i projektaktit “Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
10. Miratimi i projektaktit “Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
11. Miratimi i projektaktit për shpalljen e dy vendeve vakande për prokurorë në Prokurorinë e Posaçame kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK).
12. Të tjera (pyetje, përgjigje, diskutime.).

Z.Ibrahimi vijon me pikën e parë të rendit të ditës.

- *Miratimin e proces verbalit të mbledhjes plenare të datës 15.01./2020 i cili u është shpërndarë anëtarëve nga Kryetari.*



Kryetari i fton anëtarët për pyetje, komente.

Anëtarët paraqitën komentet si vijon:

Znj. Seiti u shpreh se procesverbali duhet të përmbajë këto 3 elemente: përmbajtjen, formën dhe rregullat drejtshkrimore. Në lidhje me procesverbalin e datës 15.01.2020, i tërhoqi vëmendjen sektorit të dokumentimit të seancave që të tregohet më i kujdesshëm për të shprehur sa më qartë qëndrimet e anëtarëve. Propozon që, në përputhje dhe me ligjin nr.115/2016, nenit 167 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli mund të mbledhet që të bien dakord në mbledhjet joformale, me qëllim që dhe proceverbali të jetë një produkt sa më profesional dhe të ketë strukturën e duhur.

Z. Ibrahimi sqaron se vërejtjet janë me vend, por duhet të merret parasysh dhe mungesa e burimeve njerëzore që ka pasur ky sektor, por që në vijëmbësi kjo praktikë do të realizohet dhe do të ketë formën e përcaktuar në ligjin nr.115/2016, nenit 167 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Z. Bazaj dhe Z. Ibrahimi gjithashtu tërhoqën vëmendje në lidhje me saktësimin e arsytimit të votës së tyre kundër, për pikën e katërt të rendit të ditës.

Z. Cani është dakord me formatin e proceverbalit të paraqitur. Konstaton mungesën e ekstremiteteve, me arsytimin që procesverbali është një dokument zyrtar dhe si i tillë duhet të përmbajë të gjitha elementët e tij.

Z. Balla sqaron se procesverbalet e mëparshme janë miratur nga Këshilli jo para mbledhjes plenare por pas saj. Shtron pyetjen se çfarë do të bëhet me procesverbalet e mëparshëm që nuk i janë nënshtruar këtij formati të ri? Shpreh pëlqimin për formatin e ri dhe propozon që, Këshilli të miratojë dhe procesverbalet e mëparshme. Thekson që, procesverbali të jetë sa më i përmbledhur, në mënyrë që të mos jetë një dublim i regjistrimit audio.

Këto vërejtje u morën parasysh dhe u pasqyruan në procesverbalin e sipërpërmendur, i cili iu vu në dispozicion anëtarëve me korrigjimet përkatëse.

Z.Ibrahimi në përfundim të diskutimeve, hedh në votim proceverbalin me ndryshimet e bëra.

Miratohen me 11 vota pro.

Z.Ibrahimi vijon me pikën e dytë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektaktit “Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ”.*

I kalon fjalën z. Staka si relator i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës i cili prezanton përpara Këshillit relacionin e miratuar nga ky komision lidhur me çështjen:

Z. Staka u shpreh se, në nenin 59 “Caktimi i përkohshëm”, të Ligjit nr.96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se: *“1.Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të: a) caktimit në pozicione të tjera; b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.*

Komisionit i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur pezullimin nga detyra të Drejtuesit për një periudhë njëvjeçare. Në këto kushte Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, bazuar në rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, propozon që prokurori Albert Murçaj të vazhdojë të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe për një afat tjetër 3 mujor (caktim i tretë) nga data 26/01/2020-25/04/2020. Sa më poshtë, pjesa hyrëse dhe konkluzioni i relacionit:

Si rezultat i vendimmarrjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i cili më datë 16.07.2019 ka marrë vendimin për ndërprerjen e caktimit të përkohshëm të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër të z.Ylli Pjetërnika, është marrë vendimi nr.142 datë 16.07.2019 “Për caktimin në pozicion të përkohshëm” të z.Albert Murçaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, me cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë për periudhën 16.07.2019-16.10.2019. Ky caktim i përkohshëm është ripërsëritur për herë të dytë për periudhën 25.10.2019-25.01.2020 me Vendimin nr.213, datë 25.10.2019.

Sa më sipër, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, bazuar në rregulloren e lartpërmendur, propozon që prokurori Albert Murçaj të vazhdojë të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe për një afat tjetër 3 mujor (caktim i tretë) nga data 26.01.2020-25.04.2020.

(Relacioni i plotë është pjesë e dokumentacionit të dosjes plenare si dhe mund të dëgjohet në regjistrimin audio të seancës të dokumentuar në faqen zyrtare të Këshillit).

Kryetari i fton anëtarët për diskutim nëse kanë rreth projektaktit të paraqitur.

Nuk ka.

Z.Ibrahimi hedh në votim.

Miratohen me 11 vota pro.

Z.Ibrahimi vijon me pikën e tretë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektaktit “Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.*



I kalon fjalën z. Staka si relator i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës i cili prezanton përpara Këshillit relacionin e miratuar nga ky komision lidhur me çështjen:

Z. Staka u shpreh se, në nenin 59 “Caktimi i përkohshëm”, të Ligjit nr.96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se: *“1.Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të: a) caktimit në pozicione të tjera; b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.*

Si rezultat i procesit kalimtar të rivlerësimit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë më datë 25.07.2019 ka marrë vendimin nr.156 “Për caktimin në pozicion të përkohshëm” të z.Brahim Dragjoshi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, me cilësinë e Drejtuesit pranë kësaj prokurorie për periudhën 26.07.2019-26.10.2019. Ka caktim është shtyrë edhe për herë të dytë nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Vendimin nr.222, datë 25.10.2019 për periudhën 27.10.2019-26.01.2020.

Sa më sipër, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, bazuar në rregulloren e lartpërmendur, propozon që prokurori Brahim Dragjoshi të vazhdojë të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër dhe për një afat tjetër 3 mujor (caktim i tretë) nga data 28.01.2020-27.04.2020.

(Relacioni i plotë është pjesë e dokumentacionit të dosjes plenare si dhe mund të dëgjohet në regjistrimin audio të seancës të dokumentuar në faqen zyrtare të Këshillit).

Z.Ibrahimi vijon me pikën e katërt të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektaktit “Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.*

I kalon fjalën z. Staka si relator i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës i cili prezanton përpara Këshillit relacionin e miratuar nga ky komision lidhur me çështjen:

Z. Staka u shpreh se, në nenin 59 “Caktimi i përkohshëm”, të Ligjit nr.96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se: *“1.Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të: a) caktimit në pozicione të tjera; b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.*

Si rezultat i procesit kalimtar të rivlerësimit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë më datë 16.07.2019 ka marrë vendimin nr.140 “Për caktimin në pozicion të përkohshëm” të z.Lorenc Mërkuri, nga prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, në cilësinë e Drejtuesit të



Prokurorisë Sarandë për periudhën 3 mujore, nga data 17.07.2019-17.10.2019. Ky caktim është shtyrë edhe për një periudhë të dytë me Vendimin nr.223, datë 25.10.2019 për periudhën 25.10.2019-25.01.2020.

Sa me sipër, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, bazuar në rregulloren e lartpërmendur, propozon që prokurori Lorenc Mërkuri të vazhdojë të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë dhe për një afat tjetër 3 mujor (caktim i tretë) nga data 26.01.2020-25.04.2020.

Kryetari i fton anëtarët për diskutim nëse kanë rreth projektaktit të paraqitur.

Nuk ka.

Z.Ibrahimi hedh në votim

Miratoheh me 11 vota pro.

(Relacioni i plotë është pjesë e dokumentacionit të dosjes plenare si dhe mund të dëgjohet në regjistrimin audio të seancës të dokumentuar në faqen zyrtare të Këshillit).

Z.Ibrahimi vijon me pikën e pestë të rendit të ditës.

- *Miratimi i projektaktit “Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.*

I kalon fjalën z. Staka si relator i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës i cili prezanton përpara Këshillit relacionin e miratuar nga ky komision lidhur me çështjen:

Z. Staka u shpreh se, në nenin 59 “Caktimi i përkohshëm”, të Ligjit nr.96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar parashikohet se: “1.Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë **jo më shumë se tre muaj**, për shkak të: a) caktimit në pozicione të tjera; b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.

Si rezultat i procesit kalimtar të rivlerësimit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë më datë 22.07.2019 ka marrë vendimin nr.148 “Për caktimin në pozicion të përkohshëm” të z.Erion Çela, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, me cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë për periudhën 23.07.2019-23.10.2019. Ky caktim i përkohshëm është shtyrë edhe për herë të dytë me Vendimin nr 218, datë 25.10.2019 për periudhën 24.10.2019-24.01.2020.

Sa me sipër, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, bazuar në rregulloren e lartpërmendur, propozon që prokurori Erion Çela të vazhdojë të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë



pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe për një afat tjetër 3 mujor (caktim i tretë) nga data 25.01.2020-24.04.2020.

(Relacioni i plotë është pjesë e dokumentacionit të dosjes plenare si dhe mund të dëgjohet në regjistrimin audio të seancës të dokumentuar në faqen zyrtare të Këshillit).

Kryetari i fton anëtarët për diskutim nëse kanë rreth projektaktit të paraqitur.

Nuk ka.

Z.Ibrahimi hedh në votim

Miratohet me 11 vota.

Z.Ibrahimi vijon me pikën e gjashtë të rendit të ditës.

- *Miratimi i projektaktit "Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.*

I kalon fjalën z. Staka si relator i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës i cili prezanton përpara Këshillit relacionin e miratuar nga ky komision lidhur me çështjen:

Z. Staka u shpreh se, në nenin 59 "Caktimi i përkohshëm", të Ligjit nr.96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar parashikohet se: *"1.Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të: a) caktimit në pozicione të tjera; b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.*

Si rezultat i procesit kalimtar të rivlerësimit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë më datë 15.04.2019 ka marrë vendimin nr.66 "Për caktimin në pozicion të përkohshëm" të z.Ludovik Doda, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, në cilësinë e Drejtuesit pranë kësaj prokurorie për periudhën 16.04.2019-16.07.2019. Po kështu më datë 16.07.2019, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka marrë gjithashtu vendimin nr.143 "Për caktimin në pozicion të përkohshëm" të prokurorit Ludovik Doda dhe vazhdimin e këtij caktimi të përkohshëm edhe për një periudhë tjetër 3 mujore, nga data 17.07.2019-17.10.2019. Caktimi i z. Doda është shtyrë edhe për një herë të tretë me Vendimin nr.221, datë 25.10.2019 për periudhën 25.10.2019-25.01.2020.

Sa më sipër, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, bazuar në rregulloren e lartpërmendur, propozon që prokurori Ludovik Doda të vazhdojë të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës dhe për një afat tjetër 3 mujor (caktim i katërt dhe i fundit) nga data 26.01.2020-25.04.2020.



(Relacioni i plotë është pjesë e dokumentacionit të dosjes plenare si dhe mund të dëgjohet në regjistrimin audio të seancës të dokumentuar në faqen zyrtare të Këshillit).

Kryetari i fton anëtarët për diskutim nëse kanë rreth projektaktit të paraqitur.

Nuk ka.

Z.Ibrahimi hedh në votim

Miratohet me 11 vota.

Z.Ibrahimi vijon me pikën e shtatë të rendit të ditës.

I kalon fjalën z. Staka si relator i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës i cili prezanton përpara Këshillit relacionin e miratuar nga ky komision lidhur me çështjen:

Z. Staka u shpreh se, në nenin 59 “Caktimi i përkohshëm”, të Ligjit nr.96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se: *“1.Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të: a) caktimit në pozicione të tjera; b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.*

Si rezultat i procesit kalimtar të rivlerësimit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë më datë 25.07.2019 ka marrë vendimin nr.157 “Për caktimin në pozicion të përkohshëm” të z.Asllan Bajramaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë për periudhën 26.07.2019-26.10.2019. Ky caktim i përkohshëm, është përsëritur edhe për një periudhë të dytë tre mujore me Vendimin nr.225, datë 25.10.2019 për periudhën 27.10.2019-26.01.2020.

Sa me sipër, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, bazuar në rregulloren e lartpërmendur, propozon që prokurori Asllan Bajramaj të vazhdojë të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet dhe për një afat tjetër 3 mujor (caktim i tretë) nga data 27.01.2020-26.04.2020.

(Relacioni i plotë është pjesë e dokumentacionit të dosjes plenare si dhe mund të dëgjohet në regjistrimin audio të seancës të dokumentuar në faqen zyrtare të Këshillit).

Kryetari i fton anëtarët për diskutim nëse kanë rreth projektaktit të paraqitur.

Nuk ka.

Z.Ibrahimi hedh në votim



Miratohet me 11 vota.

Z.Ibrahimi: Të nderuar kolegë vijojmë me pikën e tetë të rendit të ditës.

- *Miratimi i projektaktit "Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.*

I kalon fjalën z. Staka si relator i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës i cili prezanton përpara Këshillit relacionin e miratuar nga ky komision lidhur me çështjen:

Z. Staka u shpreh se, në nenin 59 "Caktimi i përkohshëm", të Ligjit nr.96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar parashikohet se: *"1.Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të: a) caktimit në pozicione të tjera; b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.*

Si rezultat i procesit kalimtar të rivlerësimit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë më datë 22.07.2019 ka marrë vendimin nr.147 "Për caktimin në pozicion të përkohshëm" të z.Lazër Çardaku, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër për periudhën 23.07.2019-23.10.2019. Ky caktim është shtyrë për herë të dytë me Vendimin nr.224, datë 25.10.2019 për periudhën 24.10.2019-24.01.2020.

Sa më sipër, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, bazuar në rregulloren e lartpërmendur, propozon që prokurori Lazër Çardaku të vazhdojë të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër dhe për një afat tjetër 3 mujor (caktim i tretë) nga data 25.01.2020-24.04.2020.

(Relacioni i plotë është pjesë e dokumentacionit të dosjes plenare si dhe mund të dëgjohet në regjistrimin audio të seancës të dokumentuar në faqen zyrtare të Këshillit).

Kryetari i fton anëtarët për diskutim nëse kanë rreth projektaktit të paraqitur.

Nuk ka.

Z.Ibrahimi hedh në votim

Miratohet me 11 vota.

Z.Ibrahimi: Të nderuar kolegë vijojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës.

- *Miratimi i projektaktit "Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.*



I kalon fjalën z. Staka si relator i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës i cili prezanton përpara Këshillit relacionin e miratuar nga ky komision lidhur me çështjen:

Si rezultat i vendimmarrjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i cili më datë 16.07.2019 ka marrë vendimin nr.145 për ndërprerjen e caktimit të përkohshëm të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër të z.Ylli Pjetërnika, është marrë vendimin nr.145/1 datë 16.07.2019 “Për caktimin në pozicion të përkohshëm” të z.Ylli Pjetërnika, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, në pozicionin e prokurorit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për periudhën 16.07.2019-16.10.2019. Ky caktim është shtyrë për herë të dytë me Vendimin nr 220, datë 25.10.2019 për periudhën 25.10.2019-25.01.2020.

Sa më sipër, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, bazuar në rregulloren e lartpërmendur, propozon qe prokurori Ylli Pjetërnika të vazhdojë të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe për një afat tjetër 3 mujor (caktim i tretë) nga data 26.01.2020-25.04.2020.

(Relacioni i plotë është pjesë e dokumentacionit të dosjes plenare si dhe mund të dëgjohet në regjistrimin audio të seancës të dokumentuar në faqen zyrtare të Këshillit).

Rreth kësaj çështje u diskutua:

Z. Balla sqaron se Këshilli në rastin e këtij prokurori, ka pasur parasysh vakancat në Prokurorinë e Tiranës dhe ky ishte një vendim atipik për Këshillin. Propozon që, si një prokuror me përvojë, ky prokuror do të jepte një kontribut më të madh pranë Prokurorisë së Lezhës, nisur dhe nga nevojat e kësaj prokurorie, atje ku ky prokuror ka dhe emërimin.

Z. Bazaj mban të njëjtin qëndrim me z. Balla. I shtron pyetjen Komisionit cilat janë kriteret ku ai bazohet në përzgjedhjen e këtyre prokurorëve, arsyet pse ata prevalojnë. I kërkon Komisionit të arsyetojë që ndërprerja e këtij caktimi të përkohshëm do të pengonte ecurinë e punës në prokurori. Duhet tu jepet mundësia të gjithë prokurorëve për të ardhur në Tiranë.

Z.Ibrahimi dakord që është rast atipik por në mëdysheje për tu bashkëngjitur qëndrimit të dy kolegëve. Kujton se, Këshilli ka qënë i detyruar të procedojë me caktimet e përkohshme, i cili është një mekanizëm paksa arbitrar derisa të hartohen Rregullorja për lëvizjen parale dhe ajo për ngritjen në detyrë. Në këto kushte, mbështet propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për mostërheqjen e propozimit.

Z. Balla shprehet se Këshilli ka hasur dhe dy praktika të njëjta, siç ishte rasti i ndërprerjes së caktimit të përkohshëm 3 mujor për Drejtuesin e Sarandës dhe atij të Kukësit. Shtron pyetjen përse Këshilli të mos veprojë në të njëjtën logjikë.

Z. Cani mbështet qëndrimin e Kryetarit. I shtron pyetjen Komisionit cilat janë shkaqet apo kriteret mbi të cilat është bazuar Komisioni për përzgjedhjen e listës së prokurorëve, të cilën ia



paraqet Këshillit. Sa kërkesa janë paraqitur Komisionit nga prokurorët që kërkojnë të lëvizin drejt Tiranës dhe nëse janë shqyrtuar këto kërkesa, cila është arsyeja që ky emër prevalon mbi emrat e tjerë. I rikujton Komisionit rastin e Prokurorisë së Burrelit dhe i kërkon të sjellë propozime konkrete, aty situata është alarmante (me një prokuror).

Z. Sheshi sqaron se lidhur me rastin që Z. Balla solli në vëmendje, nuk mund të vihet shenja e barazimit mes pozicionit të një Drejtuesi dhe atij të Prokurorit. Prokurori ka dosje në dorë dhe ndërprerja e caktimit të përkohshëm, ndikon te hetimi, ndryshe nga pozicioni i Drejtuesit. Me miratimin e Rregullores për ngritjen në detyrë dhe atë të lëvizjes paralele, do të zgjidhet ky problem.

Znj. Seiti vlerëson aftësitë dhe sakrificat e këtij prokurori gjatë periudhës kur ai drejtonte Prokurorinë e Shkodrës. Propozon vazhdimin e caktimit të përhershëm të tij, prane Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Z. Bazaj i rikujton Këshillit rastin e prokurorit të Sarandës. Kërkon kriteret mbi të cilat është mbështetur Komisioni që e ka vlerësuar këtë rast si më emergjent se rasti që ai përmendi.

Relatori i çështjes z.Beci dha këto përgjigje:

1. Prokurori është në vazhden e caktimeve të përkohshme, nuk përbën risi duke u nisur nga fakti që prok është në Tiranë. 2. Për të mos cënuar punën e prokurorisë dhe hetimin e dosjeve. Bën me dije se, Komisioni do të sjellë shumë shpejt dhe një propozim konkret për Prokurorinë e Matit dhe është në diskutime me prokurorët për të gjetur një zgjidhje sa më të pranueshme.

Z. Bazaj i kërkon Komisionit kriteret ku u bazua që ky ky magjistrat prevaloi mbi magjistratët e tjerë.

Relatori i çështjes z.Beci dha këto përgjigje:

Nuk ka asnjë kriter që prevaloi. Kur të jetë momenti i lëvizjes paralele Komisioni do të tregohet shumë i kujdesshëm që të vlerësojë sipas përcaktimeve ligjore dhe kriterëve që e bëjnë të drejtë një garë. Komisioni është në kushtet e vazhdimit të caktimit të përkohshëm të këtij prokurori për të cilin Këshilli dy herët e tjera ka rënë dakord për ushtrimin e detyrës pranë kësaj prokurorie.

Z. Dollapaj shprehet se në Komision, është diskutuar dhe më parë ky shqetësim i kolegëve. Sqaron se Komisioni caktimet i ka bërë për shkak të nevojave që ka prokuroria jo për të plotësuar kërkesat e prokurorëve. Propozon të hidhet në votim dhe secili nga anëtarët të shprehë mendimin e tij. Rikujton që kjo është një situatë e përkohshme, sepse shumë shpejt do të hartohen rregulloret përkatëse.

Z. Cani shprehet dakord për caktimet e përkohshme në dy prokuroritë pranë Gjykatës së Apelit Durrës dhe Shkodër. Përsërit qëndrimin e tij se nuk ka asnjë argument, asnjë shkresë nga



Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ku të argumentohet se ndërprerja e caktimit të përkohshëm për këtë prokuror, çënon vijueshmërinë e procesit administrativ dhe procedural, nuk ka asnjë raport mbi numrin e çështjes që ka prokuroria e Lezhës dhe ajo e Tiranës. Këshilli duhet të vlerësojë në mënyrë të barabartë dhe ti inkurajojë prokurorët.

Z. Ibrahim i sqaron se çështja e ngarkesës është argument që duhet të qëndrojë në themel të këtyre vendimeve. Këshilli është njohur me grafikët e punës së ngarkesës së punës së prokurorive. Konstaton që për këtë rast, në Këshilli po ballafaqohen dy logjika: 1. lëvizja paralele që në thelb është si një instrument karriere, 2. për shkak të nevojës së prokurorisë që ai është caktuar por dhe nevoja e një vazhdimësie në punën e një prokurori.

Z. Cani para se të shkohet te vota duhet që Këshilli ti shkojë një logjike bindëse dhe të arsyetuar. I kërkon Komisionit të japë shpjegime për këtë rast.

Znj. Seiti shprehet se nëse do të kishte vend për diskutime, të gjithë anëtarët duhet të merrnin materialin, të kishin kërkuar elementë shtesë nga Komisioni dhe për çdo pyetje që ata donin përgjigje, këto të ishin ezuaruar jashtë kësaj seance. Nuk mundet që Komisioni të japë hollësi sepse ky komision kaq munda të bëjë. Duhet të respektojmë afatin kohor.

Z. Balla i kujton Këshillit që në rastet kur nuk ka pasur dokumente të mjaftueshme, Komisioni e ka hequr propozimin.

Z. Bazaj përsërit nevojën e vënies në dispozicion të të gjithë dokumentacionit (7 ditë para mbledhjes plenare të Këshillit). Propozon që Komisioni ta tërheqë propozimin.

Z. Dollapaj nuk e shikon me vend insistimin e kolegëve për tërheqjen e këtij propozimi. Arsyet pse ky prokuror është larguar nga Shkodra kanë qënë arsyet shëndetësore dhe për shkak të rrezikimit të jetës. Konkludon që Komisioni nuk e tërheq propozimin dhe çdo anëtar është i lirë të mos e miratojë nëpërmjet votës.

Z. Beluri u shpreh se, produkti më i mirë i këtij debati duhet ti vlejë Komisionit të Karrierës për praktikantët e tjera. Komisioni duhet të sjellë argumentat mbi nevojat e prokurorisë ku bëhet caktimi i përkohshëm dhe nevojat e prokurorisë prej nga vjen magjistrati që po caktohet përkohësisht. Këshilli në këtë mënyrë do të ketë mundësinë të vlerësojë rastin konkret. Nuk e shikon të arsyeshme që ky caktim të shtyhet. Sqaron se mundësia që relacioni të plotësohet dhe të korrigjohet është e pamundur. Propozon të hidhet në votim dhe Këshilli të vendosë.

Z. Ibrahim i përsërit që caktimi i përkohshëm është një instrument defiqitar, pasi ai nuk garanton profesionalizmin e një magjistrati.

Z.Ibrahimi hedh në votim propozimin e Komisionit

Miratohet me 7 vota pro dhe 4 kundër: z. Cani, z. Balla, z. Bazaj dhe z. Ibrahim i.



Z.Ibrahimi vijon me pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektaktit për shpalljen e dy vendeve vakande për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. (SPAK)*

I kalon fjalën z. Dollapaj si relator në emër të Komisionit të Karrierës. Bazuar në shkresën e ardhur nga drejtuesi i SPAK-ut, z. Arben Kraja, ka paraqitur kërkesën për plotësimin e dy vendeve vakante nga numri total prej 15 prokurorësh. Komisioni ka realizuar një relacion të hollësishëm, ku ka paraqitur të gjithë etapat që ka kaluar Këshilli.

Në vijim të përmbushjes së detyrimeve Kushtetuese dhe ligjore nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me qëllim ngritjen dhe funksionimin e Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, bazuar në nenin 159 të ligjit nr. 115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", ligjit 96/2016 "Për statusin e qyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në mbështetje të nenit 6 dhe nenit 7 të Ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", ka dalë e nevojshme plotësimi i dy pozicioneve vakante në Prokurorinë e Posaçme, të pa plotësuar aktualisht, për të cilat nga ana e Drejtuesit të asaj prokurorie z. Arben Kraja me shkresën e datës 27.12.2019 me lëndë "Mbi plotësimin e vendeve vakante", ndër të tjera kërkon hapjen e procedurës për plotësimin e dy vendeve vakante për prokurorë që aktualisht janë të pa plotësuar nga numri total prej 15 prokurorësh"

Sa më lart, për plotësimin e strukturës së Prokurorisë së Posaçme me 10 prokurorë sikurse kërkohet nga ligji (aktualisht për plotësimin e numrit prej 10 prokurorësh, pranë prokurorisë së posaçme nga ana e KLP-së, bazuar në kërkesën e drejtuesit z. Kraja janë komanduar përkohësisht dy prokurorë), është e nevojshme të fillojë procedura përkatëse për shpalljen e dy vendeve vakante për prokurorë në atë prokurori. Me qëllim hapjen dhe realizimin e procedurës konkurruese dhe përzgjedhjes së kandidatëve nga ana e Këshillit, ka dalë e nevojshme miratimi i këtij projekt vendimi dhe njoftimi përkatës.

Sa më sipër, Komisioni i Përhershëm për Zhvillimin e Karrierës ju paraqet këtë projekt vendim.

(Relacioni i plotë është pjesë e dokumentacionit të dosjes plenare si dhe mund të dëgjohet në regjistrimin audio të seancës të dokumentuar në faqen zyrtare të Këshillit).

Kryetari i fton anëtarët për diskutim nëse kanë rreth projektaktit të paraqitur.

Anëtarët paraqitën komentet si vijon:

Znj. Seiti mendon që Këshilli duhet të hap garën për prokuror në SPAK, për ata prokurorë të cilët e kanë kaluar procesin e vetingut. Fryma e ligjit për krijimin dhe vazhdimësinë e magistratëve në SPAK, duhet të jetë që ata duhet të kenë kaluar këtë proces, edhe pse ekziston



rreziku që magjistratët që kanë kaluar këtë proces dhe të mos konkurrojnë. Propozimet e Këshillit duhet të mbështeten në listën e vitit 2019 prej 15 prokurorësh.

Z. Balla sqaron se krijimi i SPAK përkon me vitin 2019, por për vitin 2020 Këshilli duhet të ketë parasysh ligjin 97/2016 “Për organizmin dhe funksionimin e prokurorisë” në Republikën e Shqipërisë, neni 19,20, Prokurori i Përgjithshëm përcakton strukturën e prokurorive duhet të merret mendimi i tij për strukturën e SPAK–ut për vitin 2020. Nëse Këshilli e vlerëson si një propozim të ri, Këshilli mund të hapë garën për një numër më të madh se dy prokurorë.

Z. Dollapaj u shpreh se është për garën e hapur për të gjithë prokurorët. Vëren dy elementë të rëndësishëm. 1. Me çfarë rregullore do të aplikojë Këshilli për përzgjedhjen e dy kandidatëve, sepse nëse Këshilli do ti referohet Rregullores për krijimin e prokurorisë së posaçme, ku përcaktohet dhe elementi për një garë të hapur, nëse jo, atëherë nuk ka një rregullore për ngritjen në detyrë të prokurorëve, sepse në bazë neni 48 i ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, caktimi i i prokurorëve në SPAK, konsiderohet si ngritje në detyrë, problemi komplikohet atëherëduhet miratuar rregullorja për ngritjen në detyrë dhe më pas të shpallet gara për këto dy vende. Këshilli duhet të marrë në konsideratë që nuk duhet të kushtëzohet nga koha por nga procesi i cili është i rëndësishëm, sepse faktori kohë do ta çonte Këshillin në vendime të gabuara.

Z. Ibrahim i sqaron se nga diskutimet dolën në pah 3 çështje: 1. nëse do të jetë një garë e hapur për të gjithë prokurorët apo gara do të jetë e kufizuar për ata prokurorë që kanë kaluar vetingun (ligji e kërkon si kusht) 2. nëse do të veprohet nëpërmjet Komisionit të Zhvillimit të Karrierës apo duhet riaktivizuar Komisioni i Posaçëm dhe 3. Rregullorja aktuale e mundëson veprimin Këshillit apo duhet të amendohet.

Z. Cani mendon se Këshilli duhet ti qëndrojë rregullores ekzistuese dhe i shtrin efektet edhe sot (neni 17 pika 5), parashikohet qartë. Mbështet qëndrimin për garën e hapur, të mos kufizohet asnjë prokuror. Sipas rregullores Komisioni i Posaçëm i pushon veprimet me ngritjen e SPAK. Mendon që të ngrihet një Komision tjetër i Posaçëm.

Z. Staka mbështet që për shkak të situatës ku ndodhet SPAK, emergjencës, të zhvillohet një garë për ata prokurorë që kanë kaluar vetingun me vendim të formës së prerë (rreth 20 prokurorë). Është dakord për krijimin e një komisioni të posaçëm në përbërje të tij të këtë 3 anëtarë të Komisionit të Karrierës dhe dy të tjerë të zgjidhen me short dhe të hidhet në votim.

Z. Ibrahim i shtron pyetjen nëse është i nevojshëm një amendim i rregullores, lidhur me mbarimin e funksionit të komisionit të posaçëm, ku të përcaktohet që komisioni mbyll aktivitetin e tij deri në emërimin e 15 prokurorëve të SPAK –ut.

Z. Beluri mendon që nuk është e nevojshme amendimi, duhet një interpretim i rregullores është i mjaftueshëm. Këshilli ka përcaktuar numrin prej 15 që ende nuk është plotësuar ky angazhim. Mbështet garën e hapur sepse ka magjistratë që janë në pritje të procesit të vetingut shprehin



dëshirën për tu bërë pjesë e garës. Rregullorja është specifike për SPAK i përshtatet përzgjedhjes së prokurorëve për këtë strukturë.

Z. Ibrahimimi e vlerëson si zgjidhje praktike interpretimin e z. Beluri.

Z. Beci shprehet që të gjithë prokurorët që kanë pasur vullnetin për prokuror në SPAK, kanë pasur mundësinë që para një viti kur Këshilli bëri thirrjen për shpalljen e garës. Thekson që pjesa dërrmuese e prokurorëve e ka pasur mundësinë.

Z. Bazaj mendon që gara të jetë e hapur, edhe pse Këshilli ka bërë thirrje për garën para një viti.

Z. Sheshi mendon që rregullorja duhet të ketë vazhdimësi për sa i përket kandidimit. Mbështet qëndrimin e z. Beluri. Këshilli duhet ti referohet rregullores ekzistuese në të gjitha pikat e saj. Nuk është detyrë e Komisionit të Posaçëm të përzgjedhë 2 prokurorët, ky komision e mbaroi detyrën e tij me ngritjen e SPAK-ut.

Z. Dollapaj propozon të hidhet në votim shpallja e garës dhe dy elementët e tjerë Këshilli shqyrtojë në një moment tjetër.

Z.Ibrahimimi hedh në votim propozimin për një garë të hapur apo të mbyllur

Miratohet me 8 vota pro, 3 kundër: Z. Staka, znj. Seiti dhe z. Beci.

Në përfundim, Këshilli në mbledhjen e sotme plenare miratoi Vendimet për 11 pika të rendit të dtës.

Në përfundim duke mos patur pika të tjera për diskutim Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit

(Sonila Çeliku)

KRYETARI

Gent Ibrahimimi





Shënim:

(Shënimi i mëposhtëm vendoset pas përfundimit të të gjithë procedurave të rishikimit)

Lidhur me këtë proces verbal janë/nuk janë vënë në dukje pasaktësi nga anëtarët e KLP-së. Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të kryetarit Nr. ___ Datë ___ 2020/me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr. ___ datë ___ (Bashkëngjitur kopjet e dokumenteve)
Proces verbali i mësipërm u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së datë 11/09/2020
Proces verbali të arkivohet

PËRGJEGJËSI SEKTORIT SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE

Frederik Sulisufi